



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albimi” Sh.P.K. të datës 19.04.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 23.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me biçikleta për Kryeqytetin” me nr. të prokurimit 616-23-2058-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albimi” Sh.P.K. e datës 19.04.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 23.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me biçikleta për Kryeqytetin” me nr. të prokurimit 616-23-2058-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Albimi” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Albimi” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 19.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 23.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me biçikleta për Kryeqytetin” me nr. të prokurimit 616-23-2058-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është i cituar si në vijim:

- *“Përsa i përket njoftimit për kontratë, referuar pikave që përcaktojnë kushtet për pjesëmarrje dhe dëshmitë e kërkuara dokumentare, vlerësojmë se disa nga dëshmitë që kërkohen nuk janë aspak relevante për çështjen në fjalë”.*
- *“Duke pasur parasysh faktin e kohës së kufizuar për përgatitje të mostrave duke biseduar me te gjithë furnitorët tanë dhe për shkak të obligimeve kontraktuale që kemi dhe kanë, brenda dhe jashtë vendit, të cilat mund t'i dokumentojnë, kërkojmë që të shtyhet afati i dorëzimit të mostrave, të paktën deri më datë 13.06.2022. Këtë kërkesë e mbështesim edhe në faktin që jemi kompani prodhuese dhe dimë shume mire sa kohe merr krijimi I mostrave specifike siç është kërkuar nga ana juaj”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 25.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë i datës 23.03.2023;
- Dosja e tenderit së bashku me dokumentet shtojcë.

Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr.001/2022 për Prokurimin Publik (RRPP) sipas elaborimeve vijuese.

Fillimisht duhet cekur se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit nuk është në pajtim me formularin F02 dhe nuk përmban të dhënat në përpunje me nenin 60 paragrafin 60.3 të RRPP. Në pjesën e tretë ku supozohet të paraqiten të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit, parashtruesi ka paraqitur pretendimet e tij ankimore. Ndërsa pjesa e shtatë e formularit F02 ku supozohet të paraqiten të dhënat e detajuara mbi faktet dhe argumentet përkatësisht pretendimet ankimore të parashtruesit, nuk është plotësuar fare nga parashtruesi. Në anën tjetër pretendimet ankimore të evidentuara gabimisht në pjesën e tretë të formularit janë përsëritur pjesërisht edhe në pjesën e gjashtë të formularit ku supozohet të evidentohet dispozitat që pretendohet se janë shkelur nga autoriteti kontraktues. Përtej gabimeve të theksuara në plotësimin e formularit F02, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka arritur që të përcaktoj se cilat janë pretendimet e parashtruesit dhe është vazhduar me trajtimin e kërkesës për rishqyrtim bazuar në këto pretendime.

Sa i përket pjesës së pretendimit ku thuhet se “*disa nga dëshmitë që kërkohen nuk janë aspak relevante për çështjen në fjalë*” duhet cekur se parashtruesi nuk ka treguar se konkretisht cilat dëshmi sipas tij nuk janë relevante dhe cilat janë arsyet për këtë pretendim të tij. Me fjalë tjera duhet cituar saktë për cilën dëshmi është fjala dhe për cilat arsye kjo dëshmi qenka jo relevante sipas parashtruesit. Për më tepër duhet të paraqiten edhe argumente të qëndrueshme dhe prova të mjaftueshme për të vërtetuar një pretendim të tillë. Në të kundërtën autoriteti kontraktues nuk e ka as mundësinë dhe as detyrimin që të kuptoj se çka ka pasur në mendje parashtruesi kur ka thënë “*disa dëshmi janë jorelevante*”. Pasi që parashtruesi nuk ka vepruar në këtë mënyrë, është gjetur se kjo pjesë e pretendimit është tërësisht e paqëndrueshme.

Në pjesën tjetër të pretendimit parashtruesi ka argumentuar se për shkak të numrit të madh të detyrimeve kontraktuale brenda dhe jashtë vendit që ka parashtruesi dhe furnizuesit e tij, ai e ka mjaft të vështirë që të bëjë përgatitjen e mostrave brenda afatit të përcaktuar. Për këtë arsye ai ka kërkuar që të shtyhet afati për dorëzimin e mostrave deri me datë 13.06.2022. Në të kundërtën parashtruesi ka potencuar se mund të shkelet neni 7 i LPP lidhurme barazinë në trajtim dhe jo-diskriminimin e operatorëve ekonomik. Së pari data që ka kërkuar parashtruesi për shtyerje të afatit (13.06.2022), autoriteti kontraktues ka supozuar se bëhet fjalë për gabim teknik dhe se është menduar të shënohet viti 2023 dhe jo viti 2022. Tutje duhet potencuar se fakti që parashtruesi ka angazhime tjera të shumta dhe për pasojë nuk mund të përmbushë kriteret e dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, nuk është aspak diskriminuese apo favorizuese. Nga arsyetimi i vet parashtruesit rezulton se po të mos kishte parashtruesi angazhime tjera kontraktuale brenda dhe jashtë vendit, atëherë afati i përcaktuar për dorëzimin e mostrave do të ishte i mjaftueshëm. Pra nuk është kontestuese që afati për dorëzimin e mostrave është më se i mjaftueshëm, pasi që është kalkuluar paraprakisht në mënyrë profesionale duke përllogaritur në mënyrë të saktë kohën që kërkohet për të përmbushur këtë kriter (mbi 40 ditë ka qenë e hapur shpallja). Sidoqoftë, autoriteti kontraktues synon që kontraktot operator ekonomik të përgjithshëm i cili ka kohën dhe kapacitet e nevojshme për të realizuar me sukses kontratën që do të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit. Kujtojmë që ky aktivitet i prokurimit ka rëndësi specifike dhe ndërlidhet mbi të gjitha me sezonën pranverore dhe verore, që nënkupton se vonesat eventuale në afate do të shkaktonin dëme të pariparueshme. Pra nuk është aspak i qëndrueshëm pretendimi i parashtruesit që nëse nuk shtyhet afati do të shkelejt parimi i diskriminimit. Në fakt qëndron pikërisht e kundërta, nëse do të shtyhej afati për shkak se parashtruesi ka angazhime tjera kontraktuese si pasojë e të cilave nuk mund të përmbushë këtë kriter brenda këtij afati, atëherë kjo do të ishte favorizim i drejtpërdrejtë i parashtruesit dhe diskriminim i operatorëve tjerë ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Rrjedhimisht ky pretendim i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.


Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.